

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

No. Prot:

PR-3166

Data:

23.10.2020

FTESE PER OFERTE

I nderuar Partner,

E themeluar ne vitin 1995, ne jemi pjese e grupit nderkombetar ProCredit. Ne jemi te mbikqyrur nga autoritete te larta te supervizimit gjerman, Bundesbank dhe BaFin qe sigurojne besueshmerine dhe qendrueshmerine tone.

Qendrueshmeria dhe besueshmeria jone, garantohet gjithashtu nga aksioneret tane. Ne jemi nje banke me nje kapital 100 % gjerman dhe aksioneri yne i vetem eshte ProCredit Holding, me qender ne Frankfurt, Gjermani, i cili ofron drejtim strategjik per grupin e bankave ProCredit.

I. Objekti i Fteses per Oferte

- i. Sherbim linja me qira (MPLS VPN Connectivity) per Zyren Qendore dhe te gjitha Njesite e Biznesit per nevoja te ProCredit Bank
- ii. Sherbim interneti primar dhe back up

Kjo Ftese per Oferte perbehet nga:

1.	Ftesa per oferte	4 faqe
2.	Aneksi Nr. 1	2 faqe
3.	Aneksi Nr. 2	1 faqe
4.	Aneksi Nr. 3	1 faqe
5.	Aneksi Nr. 4	2 faqe
5.	Letra Anti Korrupsion	2 faqe
6.	Deklarata e gjendjes gjyqesore	1 faqe
7.	Formulari ofertes	1 faqe

II. Oferta

Oferta juaj duhet te perbehet nga:

A. Oferta Ligjore, e cila paraqet *Kriteret e Pranimiit/Kualifikimit dhe duhet te perpilohet sipas kerkesave te renditura me poshte.*

1. Subjekti duhet te provoje qe eshte i regjistruar ne regjistrin tregtar dhe per kete duhet te paraqese nje kopje te Ekstraktit Historik, te leshuar nga **Qendra Kombetare e Biznesit**.
2. Subjekti duhet te paraqese nje dokument qe verteton se subjekti juaj i ka plotesuar dhe shlyer detyrimet fiskale si dhe sigurimet shoqerore, leshuar nga Administrata Tatimore.
3. Deklarate nga administratori, qe verteton se subjekti nuk eshte ne proces falimentimi, nuk eshte denuar per shkelje penale, nuk eshte denuar me vendim te gjykates se formes se prere, qe lidhet me aktivitetin profesional (sipas formes bashkangjitur).
4. Subjekti duhet te jete i regjistruar ne Regjistrin e Sipermarresve te AKEP

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

Shenim:

Dokumentacioni i kerkuar ne Kriteret e Pranimit/Kualifikimi **ne pikat nga 1 dhe 2**, duhet te vertetohet permes dokumentave te leshuar **jo me pare se tre muaj** nga data e fundit e dorezimit te ofertes. Dokumentat e mesiperme mund te paraqiten origjinal/ te noterizuar ose kopje te dokumentave origjinale. Ofertuesit te shpallur fitues do ti kerkohet ky dokumentacion ne origjinal ose fotokopje te noterizuar.

Shenim i rendesishem:

Ne vijim te dokumentacionit me siper, subjekti duhet te dergoje nje kopje te certifikates mjedisore, ISO 14001/EMAS, ISO 50001 apo cdo certifikate tjeter ISO nese disponon

A. Oferta teknike (Kriteret e vleresimit te cilesise)


Per sherbimin e linjave me qira (MPLS VPN Connectivity) per Zyren Qendore dhe te gjitha Njesite e Biznesit, eshte e nevojshme te plotesohen kriteret teknike si me poshte:

1. Shoqeria duhet te kete minimumi dy vjet eksperience ne projektim, implementim, optimizim, menaxhim dhe suport ne teknologjine MPLS.
2. Shoqeria duhet te kete ne dispozicion Qendren Operacionale te Rrjetit (Network Operational Centre) ne funksion 24X7X365 si edhe Sistemin e Menaxhimit te Rrjetit (Network Management System) per menaxhimin , monitorimin proaktiv dhe zgjidhjen e problemeve.
3. Shoqeria duhet te kete implementuar teknologjine MPLS ne te pakten tre kliente ne sektorin financiar/bankar.
4. Konektiviteti qe do te ofrohet duhet te jete specifikisht : Zgjidhja e bazuar ne MPLS (Layer 2 ose Layer 3) me nderfaqe te bazuar ne standardin Ethernet. Nderlidhja logjike duhet te jete "full duplex" qe mundeson dergim dhe pranimin e te dhenave ne te njejten kohe.
5. Kapaciteti (bandwidth) fillestar per cdo kategori lidhje ne piken fundore duhet te jete ne perputhje me Aneksin 1. Kapaciteti duhet te kete mundesine per tu rritur nese kjo do te kerkohet me vone nga Banka.
6. Nje VPN e vecante duhet te krijohet vetem per rrjetin e Bankes dhe ne asnje rast VPN-ja do te ndahet me kliente te tjere qe ndajne rrjetin MPLS (MPLS backbone). Rrjeti MPLS duhet te aksesohet vetem nga nyjet (nodes) e Bankes. Aktualisht Banka ka te implementuar ne sistemin e saj te rrjetit DMVPN. Banka gjithashtu ne linkun e MPLS do te kete DMVPN dhe per kete kerkohet qe kjo te mos kete asnje varesi nga shoqeria qe do te perzgjidhet fituese per kete projekt gjate integritimit te rrjetit te saj MPLS. Ne vijim nuk duhet te kete varesi nga shoqeria nese Banka vendos te implementoje VPN te tjera si GETVPN, IPsec apo teknologji te tjera te ngjashme.
7. MPLS VPN duhet te suportoje lidhje nga njera pike ne tjetren (any to any conectivity) dhe duhet te jete nje grup i mbyllur perdoruesish vetem per Banken pa patur asnje interference fizike dhe logjike me kliente te tjere te trafikut te internetit.
8. Zgjidhja duhet te siguroje akses transparent te te dhenave, zerit, videove (end to end transparent data reachability, voice, video) pa filter trafikun nga shoqeria/ofruesi sherbimit.
9. Shoqeria duhet te ofroje lidhje interface-i Ethernet RJ45 per te lidhur routera-t e njesive te biznesit me rrjetin si edhe me qendren e te dhenave. Kabllimi me interface-in e kerkuar duhet te ofrohet nga shoqeria.
10. Humbja mesatare e sinjalit (average end to end packet loss) nuk duhet te jete me e larte se 1 in 1,000 per konektivitetin e fibres me paketa (packets) IMIX-i e matur per minimumin 1000 paketa.
11. Njesia maksimale e transmetimit (MTU) duhet te jete 1500 bytes.
12. Shoqeria duhet te ofroje linkun deri te router-i dhe te perfundoje ne interface-in e kerkuar te router-it te njesise se biznesit me aprovimin paraprak te Bankes.
13. Shoqeria duhet te beje te gjitha kabllimin e brendshem deri ne router-in e njesise se biznesit per funksionimin e suksesshem te lidhjes MPLS pa kosto shtese (te perfshira ne cmimin final te ofertes). Shoqeria duhet te ofroje te gjitha kabllimin e kerkuar per lidhjen e modem-it apo cdo pajisje te jashtme me router-n e njesise se biznesit per perfudnimin e linkut pa kosto shtese per Banken.

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

14. Njoftimi per mirembajtje duhet te behet te pakten 3 dite pune para dates se planifikuar. Te gjitha aktivitetet duhet te behen ndermjet orarit 22 PM dhe 6 AM CET/CEST. Kjo fashe orari nuk aplikohet per sherbimet e emergjences te cilat duhet te realizohen menjehere. Edhe ne kete rast Banka duhet te njoftohet paraprakisht
15. Shoqeria duhet te siguroje nje pike te vetme kontakti per menaxhimin e incidenteve dhe kerkesat e sherbimit si edhe nje pike tjeter kontakti per ceshtjet kontraktuale.

Si me poshte nje shembull se si do te duket setup-i nga nje perspektive e nivelit te larte:



Per sherbimin e lidhjes me internet linje primare dhe back up-i eshte e nevojshme te plotesohen kriteret teknike si me poshte:

- Linje primare
 - Lloji sherbimit: Internet i dedikuar (lidhje me fiber optike te dedikuar, simetrike dhe te qendrueshme)
 - Kapaciteti: 100 Mbps
 - Terminimi: Ethernet, RJ45 Connector
 - SLA: 99%
 - Pikat fundore:
 - o Primary site – Zyra Qendrore, Laprake
 - o Backup site – Njesi Biznesi Piazza
- Linje back up
 - Lloji sherbimit: Internet i dedikuar (lidhje me fiber optike te dedikuar, simetrike dhe te qendrueshme)
 - Kapaciteti: 50 Mbps
 - Terminimi: Ethernet, RJ45 Connector
 - SLA: 99%
 - Pikat fundore:
 - o Primary site – Zyra Qendrore, Lapraka
 - o Backup site – Njesi Biznesi Piazza

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

Per te dyja lidhjet kriteret e tjera teknike jane:

1. Lidhja duhet te jete pavarur nga trafiku (independent flat fee) me perdorim te pakufizuar, pa kufizime te tjera shtese (psh proxy, firewall, filtering server) dhe bandwidth i internetit duhet te jete i dedikuar (1:1), linje simetrike qe te mos ndahet me kliente te tjere. Shoqeria nuk duhet te kape apo ruaje transmetimet e marra apo te derguara.
2. Shoqeria duhet te ofroje nje prefiks rrjeti: a /29 IPv4 PA (network prefix) ne te dyja pikat fundore.
3. Shoqeria duhet te siguroje tipologji e hartes te rrjetit qe disponojne duke treguar te gjitha lidhjet kryesore dhe bandwidth-et e tyre te shoqeruara. Ajo duhet te kete dy ofrues upstream-i dhe ne menyre te preferueshme duhet qe te jene Tier 1 ose Tier 2 (per kete duhet te ofrohet informacioni perkates) .
4. Shoqeria duhet te garantoje 99 % funksion te plote te zgjidhjes se ofruar ne baze vjetore. Nderprerje e rrjetit quhet rasti kur sistemi i monitorimit te rrjetit te bankes nuk arrin targetet e percaktuara brenda dhe jashte rrjetit te ofruesit te sherbimit. Shoqeria/ofruesi i sherbimit duhet te vendose targete te arsyeshme qe mund te perdoren per monitorimin e rrjetit.
5. Shoqeria duhet te jete e afte te garantoje funksionalitetin e rrjetit me shume se 99% te kohes perjashtuar rastet kur problemi shkaktohet nga pajisjet e Bankes, shkeputja e fibres apo kabllimit nga palet e treta ose ngjarje jashte kontrollit te ofruesit te sherbimit.
6. Shoqeria duhet te garantoje se 95% e bandwidth-it do te jete ne funksion ne cdo moment per te arritur destinacionin brenda rrjetit te saj.
7. Shoqeria duhet te garantoje qe humbja ne paketa (packet loss) nuk do te kaloje 0.01% per 99% te kohes ne baza mujore. Kjo do te matet nga sistemi i monitorimit te Bankes duke derguar probes te nje set i percaktuar targetesh brenda dhe jashte rrjetit te shoqerise e cila duhet te vendose targete te arsyeshme qe mund te perdoren per kete qellim.
8. Njoftimi per mirembajtje duhet te behet te pakten 3 dite pune para dates se planifikuar. Te gjitha aktivitetet duhet te behen ndermjet orarit 22 PM dhe 6 AM CET/CEST. Kjo fashe orari nuk aplikohet per sherbimet e emergjences te cilat duhet te realizohen menjehere. Edhe ne kete rast Banka duhet te njoftohet paraprakisht
9. Shoqeria duhet te siguroje nje pike te vetme kontakti per menaxhimin e incidenteve dhe kerkesat e sherbimit si edhe nje pike tjeter kontakti per ceshtjet kontraktuale.
10. Shoqeria duhet te kete ne dispozicion Qendren Operacionale te Rrjetit (Network Operational Centre) ne funksion 24X7X365 si edhe Sistemin e Menaxhimit te Rrjetit (Network Management System) per menaxhimin , monitorimin proaktiv dhe zgjidhjen e problemeve.

Shenim i rendesishem:

Kriteret e siperpermendura teknike per te tre sherbimet e kerkuara jane **kritere skualifikuese**. Per kete kerkohet qe shoqeria juaj te ofroj informacion te plote e te detajuar per permbushjen e te gjitha kriterëve te kerkuara ne kete ftese.

1. Kapaciteti teknik dhe profesional si edhe eksperience te ngjashme:

Shoqeria juaj, duhet te provoje se disponon aftesite teknike dhe profesionale per realizimin e objektit te kerkuar, ne kete proces tenderimi permes dokumentacionit si me poshte:

- CV e detajuar e shoqerise suaj per aktivitetin qe nga data e themelimit ku te perfshihen te gjitha eksperiencat tuaja te meparshme. Pjesa e CV-se duhet te jete dhe perberja e stafit ku te detajohen kualifikimet e tyre profesionale apo cdo sqarim shtese qe konfirmon kualifikimin e tyre per kryerjen e sherbimeve te kerkuara.
- Leter reference leshuar nga institucione te ndryshme private apo publike per te cilet shoqeria juaj ka kryer realizime te ngjashme ose kopje te kontratave perkatese.

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

- Liste te shoqerive per te cilat keni ofruar/realizuar projekte te njejta ose te ngjashme ne 5 vitet e fundit.
- Shoqeria juaj duhet te percaktoj qarte kohezgjatjen per implementimin e linjave per cdo sherbim te shprehur ne dite pune
- SLA e detajuar per ofrimin e sherbimit
- Informacion i detajuar per shtrirjen gjeografike te linjave.

Shoqeria juaj mund te dergoj edhe dokumenta shtese dhe sqarime tjera, te cilat mendoni se do te qartesoje me mire oferten tuaj.

Bashkengjitur me kete Ftese per Oferte (Pjesa Teknike dhe Ligjore) do te gjeni Letren Antikorrupsion, dhe Deklaraten mbi Gjendjen Gjyqesore te cilat duhet te firmosen nga perfaqesues te subjektit tuaj dhe duhet te shoqerojne oferten tekniko-ligjore.

B. Oferta Ekonomike

Oferta ekonomike duhet t'u permbahet kerkesave te Aneksit Nr. 1, bashkangjitur kesaj ftese per oferte. Cmimet e ofruara duhet te perfshijne TVSH-ne dhe monedha e kuotuar duhet te jete ne Leke.

Formulari i Ofertes: Bashkangjitur me ftesen per oferte (Pjesa Financiare) eshte Formulari i Ofertes i cili duhet te firmoset/vulohet nga shoqeria juaj dhe te dergohet se bashku me oferten ekonomike.

IV. Dorezimi i Ofertes

Oferta juaj duhet te jete e ndare ne dy zarfa te ndryshem. Dokumentacioni ligjor dhe teknik duhet te jete ne nje zarf dhe oferta ekonomike ne nje zarf tjeter.

Te dyja keto zarfe te cilat duhet te shenojne qarte se cfare permbajne. Zarfat duhet te jete te vulosur nga shoqeria ne pjesen e ngjitjes se tyre. Ata duhet te kete te shkruar qarte: **Sherbim konektiviteti per nevoja te ProCredit Bank**, si dhe Emrin e Shoqerise qe e dergon. Zarfat duhet te protokollohen prane recepsionit te Zyrave Qendrore te PCB-se dhe Shoqeria duhet te sigurohet qe kjo oferte eshte protokolluar. Per te shmangur cdo paqartesi, kerkojme qe perfaqesuesi i shoqerise te mos largohet nga Zyrat Qendrore te PCB-se pa marre numrat e protokollit te ofertes. **Ne total duhet te jene dy numra protokolli.**

Ne rast se oferta juaj dorezohet e hapur, me e-mail, fax ose ne ndonje menyre tjeter nga ajo e kerkuar me lart, oferta nuk do te konsiderohet e vlefshme.

Oferta juaj, ne nje zarf te mbyllur dhe te vulosur, ne formatin e kerkuar do te adresohet dhe paraqitet ne:

Ref: 20200113- Sherbim konektiviteti per nevoja te ProCredit Bank

Rr. Dritan Hoxha
Laprake, Tirane

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

V. Vleresimi i Ofertes

Shoqerite pjesemarrese do te vleresohen sipas kriterëve te meposhtme:

Kriteret e Vleresimit	Pesha specifike (%)
Termat financiare (oferta financiare)	40
Termat Teknike	60

Kriteret teknike (te vleresuara me pike)	Pesha specifike per secilin kriter teknik (%)
Eksperienca te ngjashme te shoqerise ne treg	20
Eksperienca me PCB-ne	10
Termat e SLA se ofruar	50
Afati i implementimit	20

Sqarim:

- Pas shqyrtimit te ofertes tekniko – ligjore, Banka procedon me hapjen e ofertes financiare.
- Shoqerite te cilat nuk plotesojne kriteret e cilesuara si skualifikuese nuk do te kualifikohen per ne fazen tjeter dhe oferta e tyre financiare nuk do te hapet.
- Banka do te njoftoje me shkrim nese jeni perzgjedhur ose jo fitues.
- Shoqeria qe do te grumbulloje me shume pike ne perfundim te dy fazave (teknike dhe financiare), do te perzgjidhet nga Banka per te bashkepunuar per sherbimet e kerkuara objekt te kesaj ftese per oferte per nje periudhe tre vjecare.
- Oferta juaj do te jete e vlefshme nese propozimi juaj do te perfshije te gjitha sherbimet e kerkuara apo nje pjese te tyre.
- Banka ruan te drejten te zgjedhe nje ose me shume shoqeri per realizimin e nje sherbimi.

VI. Afati i dorezimit

Afati i fundit per dorezimin e ofertave ne Banke, ne adresen e mesiperme eshte date **6 Nentor 2020, ora 16.00.**


Per cdo pyetje ju lutem mos hezitoni t'i adresoni ne: info_procurement@procredit-group.com.

Per cdo ankese ne lidhje me vendimin per procesin e prokurimit ju lutemi mos hezitoni t'i adresoni ne: albankesaprokurime@procredit-group.com.

Ju lutem percaktoni ne oferten tuaj menyren e marrjes se kesaj Ftese per Propozim duke vendosur nje kryq per nje nga menytrat e meposhtme:

- a) derguar me poste nga banka _____
- b) nepermjet internetit _____
- c) eshte terhequr prane bankes _____
- d) nga shoqeri te tjera _____

Singerisht,
ProCredit Bank sh.a



Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

Aneksi Nr. 1: Oferta Financiare dhe Specifikime teknike

Oferta juaj financiare do te jete e vlefshme nese plotesohet sipas tabelave me poshte:

- i. Sherbim linja me qira (MPLS VPN Connectivity) per Zyren Qendore dhe te gjitha Njesite e Biznesit per nevoja te ProCredit Bank

Nr	Njesi Biznesi	Adresa	Bandwidth	Media type	Njesia	Sasia	Cmimi/njesi
1	Zyra Qendrore	Laprake, Tirane	100 Mbps	RJ-45 / SFP	Sherbim/muaj	1	
2	Qendra rajonale e te dhenave (DRC) Piazza	Piazza, Tirane	100 Mbps	RJ-45			
3	Durres		10 Mbps	RJ-45			
4	Shkoder		10 Mbps	RJ-45			
5	Korçe		10 Mbps	RJ-45			
6	Kombinati		10 Mbps	RJ-45			
7	Vore		10 Mbps	RJ-45			
8	Piazza		10 Mbps	RJ-45			

- ii. Sherbim interneti primar dhe back up

Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Cmimi / Njesi	
				Kapaciteti 100 Mbps	Kapaciteti 50 Mbps
1	Sherbim Interneti	Sherbim/muaj	1		

Shenime:

- Cmimet e mesiperme duhet te jene ne monedhen Leke dhe te perfshijne te gjitha detyrimet tatimore.
- Cmimi per njesi duhet te perfshije te gjitha kostot e nevojshme per realizimin e ketij sherbimi.

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

Aneksi Nr. 2

Referenca per kontrata te ngjashme

Nr	Klienti	Data e fillimit te kontrates	Data e perfundimit te kontrates	Qyteti ku eshte ofruar sherbimi	Personi kontaktit/pozicioni	Numri i telefonit te personit te kontaktit
1	XXXXXXXXX	1 Janar 2017	30 Dhjetor 2018	Tirane		068xxxx
2	YYYYYYYYY	15 Mars 2016	15 Qershor 2016	Durres, Lezhe		068xxxx
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
Etj						

Shenim: Shembujt e mesiperm jane dhene per te treguar si duhet te plotesohet tabela e referencave

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

Aneksi Nr. 3: Kushtet paraprake te kontrates

Banka ruan te drejten e ndryshimit te ketyre kushteve paraprake:

Banka ProCredit sh.a. nje shoqeri aksionare e krijuar dhe qe ekziston ne baze te legjislacionit shqiptar, regjistruar ne Regjistrin Tregtar me numer identifikimi (NIPT) J91524011J, me seli ne adresen: Rruga "Dritan Hoxha", Tirane, e perfaqesuar qe ketu me poshte do te quhet "Perdoruesi" dhe _____ qe ketu e me poshte do te quhet "Operatori"

1. Objekti i kontrates: Operatori ofron linje _____, per transmetimin e te dhenave .
2. Kjo Kontrate hyn ne fuqi me nenshkrimin e kontrates nga palet dhe eshte vlefshme per nje periudhe _____.
3. Palet konfirmojne venien ne pune te linjes sipas objektit te kesaj kontrate me ane te Proces-Verbalit te testimit dhe te mirefunksionimit i cili do te firmoset nga Palet.
4. Periudha e testimit te linjes eshte 1 muaj nga perfundimi i instalimit.
5. Periudha e instalimit eshte brenda _____ diteve nga marrja e njoftimit nga Perdoruesi.
6. Pagesa kryhet nga Perdoruesi per cdo muaj te perdorimit te linjes, brenda 30 diteve te muajit pasardhes si dhe paraqitjes se fatures tatimore, ne numrin e llogarise se Operatorit ne Banken ProCredit Bank. Operatori eshte i detyruar te leshoje fature te rregullt tatimore sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.
7. Çmimet e kesaj kontrate perfshijne te gjitha kostot dhe shpenzimet per realizimin e sherbimit, si dhe te gjitha detyrimet e tjera fiskale sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Keto çmime mbeten te pandryshuara gjate gjithe kohezgjatjes se kontrates. Ne rast se operatori nuk ka numer llogarie ne Banken ProCredit, ai eshte i detyruar ta hape ate brenda 48 oreve nga njoftimi i shpalljes fitues.
8. Per cdo shqetesim qe mund te kete Perdoruesi lidhur me linjen objekt i kesaj kontrate Operatori do te paraqitet tek Perdoruesi brenda _____ oreve nga njoftimi dhe do te zgjidhe cdo problem te linjes brenda _____ oreve nga njoftimi.
9. Perdoruesi merr persiper te perdore linjen vetem per nevojat e veta dhe nuk ka te drejte ta jape ate ne perdorim te treteve ose te beje lidhje paralele.
10. Palet bien dakort te rakordojne per cdo defekt dhe kohezgjatje te tyre.
11. Perdoruesi ka te drejte ta zgjidhe kontraten menjehere, nese gjate periudhes nje mujore te testimit nga operatori nuk eshte siguruar sherbimi sipas percaktimeve te kontrates.
12. Perdoruesi ka te drejte te kerkojne nderprerjen e sherbimit te nje linje objekt i kontrates duke njoftuar operatorin me shkrim te pakten nje muaj perpara.
13. Palet kane te drejte te zgjidhin kontraten e sherbimit perpara afatit te perfundimit te saj duke njoftuar me shkrim njera tjetren te pakten tre muaj perpara.
14. Kontrata mund te zgjidhet nga secila pale menjehere ne rast mospermbushjeje te perseritur te detyrimeve kontraktuale.
15. Ne rast te nderprerjes kumulative te sherbimit per nje periudhe deri ne 4 (kater) ore ne dite Perdoruesit i lind e drejta ta penalizoj operatorin ne masen 50% te vleres ditore te kontrates.
16. Ne rast te nderprerjes kumulative te sherbimit per me teper se 4 (kater) ore ne dite, Perdoruesit i lind e drejta te mos paguaje per ditën perkatese gjate te ciles ka ndodhur nderprerja.
17. Ne rastin se operatori nuk siguron sherbimin objekt kontrate brenda afati te instalimit, atehere ai penalizohet per cdo dite vonese ne masen 100% te vleres ditore te kontrates.
18. Te gjitha njoftimet, komunikimet midis Paleve ne kete Kontrate do te behen me shkrim, duke iu dorezuar personalisht personave perfaqesues ose atyre te ngarkuar me pergjegjesi, dorazi, me ane te postes apo e-mailit.

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

19. Palet ndalohen te japin ne pale te treta informacion te fituar gjate ekzekutimit te kesaj kontrate si dhe cdo informacion ne lidhje me kete kontrate. Operatori do te respektoje te gjitha standartet dhe parimet e etikes dhe biznesit ne veprimtarine e tij ne kuader te kesaj marreveshje.
20. Gjate ekzekutimit te kontrates palet do te perpiqen te zgjidhin mosmarreveshjet me mirekuptim, ne rast te kundert ato do ti drejtohen per zgjidhje Gjykates se Rrethit Gjyqesor.
21. Kjo kontrate hartohet ne dy kopje nga nje kopje per sejcilen pale.

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

Aneksi Nr. 4:¹

Pyetesi i ILO-s per perputhshmerine e furnitoreve

1. Informacione te pergjithshme

Emri i kompanise	
Produktet kryesore dhe sektori	
Shteti/shtetet e prodhimit/operimit	
A i eksportoni/ofroni produktet/sherbimet tuaja ne vendet e BE-se?	

2. Shendeti dhe siguria profesionale

A ka vendosur dhe a zbaton kompania juaj procedura per shendetin dhe sigurine profesionale ne perputhje me praktikat e mira nderkombetare te industrise per te parandaluar aksidentet, demtimet dhe semundjet? A mund te rendisni disa nga udhezimet/standartet dhe procedurat perkatese? Sa shpesh rishikohen apo monitorohen ato?	
A ka kualifikime/trajtime specifike qe duhet te kete stafi juaj per te kryer detyra te caktuara? Si i ndiqni nevojat per trajnim? Nje here ne sa kohe zhvillohen trajtime?	
Si e ndiqni dhe si e raportoni shkallen e demtimeve, semundjeve profesionale, ditet e mungesave, fenomenin e te munguarit ne pune dhe numrin e viktimave qe lidhet me punen?	
Si i parandaloni zjarret dhe çfare do te benit ju dhe stafi juaj ne rast emergjence per shkak te nje zjarri?	
Nese pyetja vlen per kompanine ne fjale: A e pajisni stafin me pajisje mbrojtese? Nese po, çfare pajisjesh?	

3. Barazia ne mundesi dhe ne trajtim

Si e ndiqni diversitetin ne kompanine tuaj?	
---	--

¹ Pyetesi i hartuar ne perputhje me politikat pro mjedisore te Bankes

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

Si e parandaloni diskriminimin ne kontekstin e rekrutimit, shperblimit dhe ngritjes ne detyre? A keni mekanizma per shqyrtimin e ankesave?	
A aplikoni mekanizma/politika/programe specifike per te inkurajuar grate apo grupet e tjera vulnerabel? Per shembull, ketu mund te perfshihen targetet lidhur me raportin specifik femra-meshkuj, programe mentorimi te projektuara specifikisht, si dhe koncepte specifike per komunikimin me grupet vulnerabel.	

a. Dokumentacion shtese

Ju lutemi, ndihuni te lire t'i bashkengjitni pergjigjes suaj per pyetjet e mesiperme dokumentet perkatese (pra, procedura, udhezime, politika dhe standarde, nese deshironi).

b. Konfirmimi

Data dhe vendi

Emri i plote dhe pozicioni

Firma

Me nenshkrimin e ketij dokumenti, nenshkruesi konfirmojne se kane autoritetin te nenshkruajne ne emer te kompanise dhe te japin pergjigje plotesisht te verteta.

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

Letra Antikorrupsion (Deklarata e Perputhshmerise)

Grupi ProCredit vlereson se ndikimet etike, shoqerore dhe mjedisore jane pjese e rrjetit te furnizimit. Veç kesaj, ndikimet pozitive mund te arrihen permes blerjes se produkteve dhe/ose sherbimeve me te pergjegjshme, si dhe duke punuar bashkerisht me furnitorët për të ndikuar pozitivisht në performancën etike, shoqerore dhe mjedisore. Ndaj, Grupi ProCredit pret prej furnitoreve/kontraktoreve të tij që t'i përmbahen një pakete standardesh minimale për të garantuar pajtueshmërinë e angazhimeve të tyre për çështjet kryesore shoqerore, mjedisore dhe të administrimit me standardet e larta të ProCredit. Njesoj siç vepohet me klientët, Grupi ProCredit pret prej furnitoreve dhe kontraktoreve të tij që të mos angazhohen në asnjë prej veprimtarive të renditura në Listën e Perjashtimit të ProCredit. Aktivitetet me të rëndësishme, por jo të vetmet, që përmban kjo listë janë:

-Prodhimin ose veprimtaritë që përfshijnë formë të demshme ose shfrytëzuese të punës së detyruar/punës së demshme për fëmijët, praktikën diskriminuese ose praktikën që i pengojnë punonjësit të ushtrojnë në mënyrë të ligjshme të drejtat e tyre të lirise së organizimit dhe të negociimit kolektiv (për hollësi të mëtejshme, shihni pikën a) të Listës së Perjashtimit)

-Respektimi i ligjeve dhe rregulloreve kombëtare, si dhe konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për prodhimin dhe/ose tregtimin e çdo produkti apo veprimtarie (për hollësi të mëtejshme, shihni pikën e) të Listës së Perjashtimit)

-Shoqëria konfirmon se nuk kryen aktivitete tregtare të gjendura në listën përjashtimore të ProCredit Grup.

-Duke qenë se Grupi ProCredit i përmbahet Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (1948) pret që të njejtën gjë të bëjnë edhe furnitorët dhe kontraktorët e tij. Kështu, shoqëria tregtare konfirmon se iu përmbahet standarteve dhe etikës me të lartë të biznesit gjatë procesit të tenderit dhe gjatë zbatimit të kontratës. Ajo zbaton standartet e Shëndetit, Sigurisë në punë, Sigurisë Mjedisore dhe standartet e ILO dhe nuk është e përfshirë në punën e detyruar ose në punën e paligjshme të fëmijëve. Gjithashtu shoqëria konfirmon se nuk është e përfshirë në praktikën diskriminuese apo praktikën që ndalojnë punëmarresit e saj për të ushtruar të drejtën e tyre ligjore për t'u mbledhur dhe anëtarësuar në organizatat e punëmarresve.

-Shoqëria pranon se përfshirja e saj në një nga praktikën e paligjshme të përmendura më sipër, do të sjellë përjashtimin e saj nga procedura e tenderimit ose ndërprerjen e kontratës në mënyrë të menjëhershme nga ana e ProCredit Bank sh.a.

- Siç përcaktohet në Kodin e Sjelljes, Grupi ProCredit nuk toleron rastet e pastrimit të parave, mitmarjes dhe korrupsionit. Prandaj, marrëdhëniet e biznesit nuk mund të krijohen ose të vazhdojnë në rast se mesohet që një furnitor potencial është i përfshirë në rastet e pastrimit të parave, korrupsionit dhe/ose mashtrimit. Thëksohet se Grupi ProCredit nuk pranon rryshfete të asnjë forme dhe as nuk pranon angazhimin e furnitoreve në praktikën e tillë.

Furnitorët dhe kontraktorët që rezultojnë të përfshirë në veprimtari të kësaj natyre, do të përjashtohen nga mundësia për t'u bërë partnerë.

-ProCredit Bank do të refuzojë ofertat pjesëmarrëse në tender, nëse deshmohet ose nëse konsiderohet se shoqëria është e përfshirë në ndonjë rast të pastrimit të parave, mashtrimit ose në raste korrupsioni gjatë procesit të tenderit ose do të anulohet kontrata nëse deshmohet se ka ndodhur ndonjë nga keto raste gjatë procesit të dhenies së kontratës.

-Për qëllimet e kësaj politike aktivitetet e mëposhtme do të konsiderohen si korrupsion:

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

- a) Veprimin e te dhenit, pranuarit ose kerkimit te mjeteve te çfaredo vlere, per te ndikuar te ndonje person tjeter juridik, personel te PCB-se ose te ndonje shoqeri tjeter, gjate procesit te tenderimit ose gjate dhenies se kontrates.
 - b) Demtimin e prones se PCB-se, kercenimin e personelit te PCB-se, kercenimin per demtim te reputacionit te PCB-se ose ndonje shoqerie tjeter per te ndikuar ne procesin e tenderimit ose per zbatimin e kontrates se dhene.
 - c) Marreveshjen ne mes te dy ose me shume shoqerive per te imponuar ose per te ndikuar ne tenderet e papershtatshem, tendere me çmime artificiale ose çmime jo konkurruese.
 - d) Falsifikimin e qellimshem, ndryshimin, fshehjen ose paraqitjen e gabuar te informatave te kerkuara ose te paraqitura gjate procesit te tenderit ose gjate zbatimit te kontrates.
- Per qellimet e kesaj politike veprime te mashtrimit konsiderohen perpjekjet ose pakujdesite e qellimshme per te mashtruar ose perpjekjet per te mashtruar stafin e PCB-se ose shoqerive te tjera, ne menyre indirekte ose te drejtperdrejte, per te perfituar financiarisht ose per t'ju shmangur detyrimeve te percaktuara me kontrate ose me ligj.

Grupi ProCredit pret prej furnitoreve te tij te angazhohen dhe te respektojne ndershterisht standardet e percaktuara ne kete dokument. Furnitoret priten te demonstrojne angazhimin e tyre duke bashkepunuar ngushtesisht me Grupin ProCredit, si dhe duke ofruar akses te arsyeshem ne dokumentacionin/informacionin perkates, nese gjykohet e nevojshme. Ne rastin e shkeljeve te renda dhe/ose te vazhdueshme te standardeve te percaktuara ne kete dokument, Grupi ProCredit do te ndermarre hapat e nevojshem per nderprerjen e marredhenieve te biznesit.

Me nenshkrimin e ketij dokumenti, nenshkruessit konfirmojne autoritetin e tyre per te nenshkruar ne emer te furnitorit dhe per t'u angazhuar per respektimin e standardeve te percaktuara ne te.

Deklarata per t'u nenshkruar nga furnitori/kontraktori

Emri i kompanise

Numri i regjistrimit

Numri i kontrates/tenderit

Adresa

Data

Nenshkrimi i autorizuar

Emri

Titulli

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

DEKLARATE MBI GJENDJEN GJYQESORE

E shoqerise pjesemarrrese ne proceduren e prokurimit qe do te zhvillohet ne date _____ nga
Banka ProCredit sh.a. me objekt _____

Une i nenshkruari _____ me cilesine _____ te shoqerise _____
deklaroj se:

- Shoqeria _____ nuk eshte denuar per shkelje penale,
- Shoqeria _____ nuk eshte denuar me vendim te gjykates se formes se
prere, qe lidhet me aktivitetin profesional,
- Shoqeria _____ nuk eshte ne proces falimentimi

Data e dorezimit te deklarates _____

Perfaqesuesi i ofertuesit

Nenshkrimi

Vula

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

FORMULAR OFERTE

[Ofertuesi duhet te plotesoje kete Formular ne perputhje me udhezimet e treguara. Nuk lejohen ndryshime apo zevendesim te ketij formati.]

Date: ____/____/_____
[plotesoni daten (dite,muaj,vit) e dorezimit te ofertes]
Numri i fteses :.....:

Per: **ProCredit Bank**
Departamenti Finances
Tirane, Shqiperi

Ne, te nenshkruarit, deklarojme qe:

- (a) Ne kemi shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur ne kete procedure prokurimi dhe pranojme, pa rezerva ose perjashtime, kerkesat, afatet dhe kushtet e shprehura ne to;
- (b) Ne sigurojme furnizimin ne perputhje me Dokumentat e Tenderit, Afatet e Levimit per Mallrat dhe Sherbimet respektive si me poshte _____ *[plotesoni shkurtimisht mallrat, apo sherbimet respektive];*
- (c) Ne permbushim gjithë kerkesat ligjore, financiare-ekonomike dhe teknike te specifikuara ne dokumentat e tenderit si vertetohet nga certifikatat dhe dokumentat e dorezuara me kete deklarate.
- (d) Cmimi total i Ofertes sone, perfshire cdo detyrim tatimor eshte: _____ *[plotesoni cmimin total te ofertes me numra dhe fjale, si dhe monedhen];*
- (e) Oferta jone do te jete e vlefshme nga data e dorezimit te ofertes deri me date.....;
- (f) Nese oferta jone do te pranohet, ne angazhohemi te mbajme nje garanci kontrate ne perputhje me dokumentat e tenderit nese kjo eshte e aplikueshme;
- (g) Ne nuk kemi konflikt interesi ne perputhje me Letren Antikorrupsion;
- (k) Ne kuptojme se kjo oferte, sebashku me njoftimin tuaj zyrtar te shpalljes se fituesit do te sherbeje si nje kontrate e perkohshme ndermjet nesh, derisa te pergatitet dhe nenshkruhet kontrata zyrtare.
- (l) Ne kuptojme qe nuk jeni te detyruar te pranoni oferten me cmimin me te ulet ose çdo oferte tjeter qe ju mund te merrni.

Firmosur: _____

Date: _____